ANTE GROUP sh.p.k.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7-22

GRAVITAS - MIGELA XHANI
AUDITUESE LIGJORE

Rruga "George W. Bush"; Ndërtesa 5, Hyrja 5, Zyra 11, Tiranë

OPINIONI I AUDITIT TË PAVARUR

Drejtuar : Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Ante-Group" shpk

Opinioni

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare të Shoqërisë *"Ante-Group" shpk* (Shoqëria), të cilat përfshijnë "Pasqyrën e Pozicionit Financiar me datën 31 Dhjetor 2020", "Pasqyrën e të Ardhurave Gjithpërfshirëse", "Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital" dhe "Pasqyrën e Flukseve të Parasë" për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe "Shënimet për Pasqyrat Financiare", në të cilat përfshihet edhe një përmbledhje e politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*.
Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.
Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Administrimin, në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi (përfshirë mangesitë e rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm).

Migela XHANI

AUDITUESE LIGJORE

MIGELA XHANI
EKSPERT KONTABEL
TIRANË

Tiranë më, 12.06.2021

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2020

	Shënimi	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
AKTIVE			
Mjete monetare	1	36,567,719	745,144
Klientë	2	358,429,323	121,364,073
Llogari te arkëtueshme	3	7,411,305	26,702,574
Inventari	4	22,264,796	22,428,745
AAM të mbajtura për shitje	3	20,260,206	44,494,792
Shpenzime të periudhave të ardhme	5	12,646,878	29,893,397
Aktive Afatshkurtra		**457,580,227**	**245,628,725**
Tituj pronësie në njësitë brenda grupit	6	-	19,219,196
Huadhenie	6	25,671,540	-
Toka dhe Ndërtesa	7	41,258,230	129,143,760
Makineri,paisje dhe të tjera	7	84,538,885	96,727,669
Parapapagime per blerje AAM	7	398,311,008	381,177,230
Aktive Afatgjata		**549,779,663**	**626,267,855**
TOTAL AKTIVE		**1,007,359,890**	**871,896,580**
DETYRIMET			
Hua afatshkurtër	8	185,884,634	171,177,761
Arketime ne avance	9	69,977,740	
Furnitorë për blerje	10	349,078,033	183,145,134
Detyrime tatimore	11	35,547,875	2,386,323
Detyrime të tjera afatshkurtra	11	101,540,495	139,390,520
Detyrimet Afatshkurtra		**742,028,777**	**496,099,738**
Hua afatgjatë	12	34,058,608	168,602,748
Detyrime të tjera afatgjata		-	-
Detyrimet Afatgjata		**34,058,608**	**168,602,748**
Kapitali i nënshkruar	13	142,000,000	142,000,000
Rezervat Ligjore dhe Rezerva të Tjera	13	10,876,769	10,876,769
Rezultate të mbartura		17,325	40,336
Rezultati i Periudhës	22	78,378,411	54,276,989
Kapitalet e Veta		**231,272,505**	**207,194,094**
TOTAL DETYRIME DHE KAPITALI		**1,007,359,890**	**871,896,580**

Gjysho Merko
ADMINISTRATOR

Bardhjus Bushaj
ADMINISTRATOR

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet lexuar e lidhur me Shënimet shpjeguese në faqet 8-23, pasi janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare

NUIS: K62004100D
ANTE-GROUP
sh.p.k
ALBANIA

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN QË MBYLLET MË 31 DHJETOR 2020

	Shënimi	Viti që mbyllet më 31 Dhjetor 2020	Viti që mbyllet më 31 Dhjetor 2019
Shitje neto	14	1,116,459,598	649,623,231
Ndryshimi në gjendjen e prodh.të gatshëm dhe në proces		-	-
Puna e kryer nga njësia dhe e kapitalizuar	14	-	-
Të ardhura të tjera nga veprimtaria	14	-	10,102,632
Total TE ARDHURA	21	**1,116,459,598**	**659,725,863**
Materialet e konsumuara dhe shërbimet	15	(299,286,006)	(229,229,635)
Kosto e punës	16	(132,729,696)	(122,262,300)
Amortizimi dhe zhvlerësimet	7,17	(23,932,176)	(26,134,596)
Shpenzimet operacionale	18	(560,164,354)	(213,501,022)
Shpenzime financiare	19	(7,594,182)	(4,309,322)
Total SHPENZIME		**(1,023,706,414)**	**(595,436,875)**
Fitimi para tatimit	22	**92,753,184**	**64,288,988**
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	20	(14,374,773)	(10,011,999)
Fitimi pas tatimit	21	**78,378,411**	**54,276,989**

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

	Shënimi	Viti që mbyllet më 31 Dhjetor 2020	Viti që mbyllet më 31 Dhjetor 2019
Diferenca (+/-) nga përkëthimi i veprimtarisë në monedhë të huaj		0	0
Diferenca (+/-) nga rivlerësimi i AAM		0	0
Diferenca (+/-) nga rivlerësimi i AF të mbajtura për shitje		0	0
Pjesë të të ardhurave gjithëpërfshire nga pjesmarrjet		0	0
Totali i të Ardhurave Gjithëpërfshirëse		**0**	**0**

Pasqyra e Performancës Financiare duhet lexuar e lidhur me Shënimet shpjeguese në faqet 8-22, pasi janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE PËR VITIN QË MBYLLET MË 31 DHJETOR 2020

	Shënimi	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Flukse monetare nga veprimtaria operative			
Fitimi para tatimit		92,753,184	64,288,988
Rregullime për :			
Amortizimin dhe zhvlerësimet	7	23,932,176	26,134,596
Rritje/ rënie i Llog. të Arkëtueshme Tregëtare	2	(237,065,250)	26,711,050
Rritje/ rënie i Llog. te Tjera të Arkëtueshme	3	60,772,374	59,842,542
Rritje/ rënie në inventar	4	163,949	(16,315,092)
Rritje/ rënie i Llog. të Pagueshme Tregëtare	10	165,932,899	35,922,928
Rritje/ rënie i Llog. të Tjera të Pagueshme	11	65,289,267	116,735,679
		171,778,599	**313,320,691**
Tatim fitimi i paguar	20	(14,374,773)	(10,011,999)
Flukse monetare neto nga veprimtaria operative		**157,403,826**	**303,308,692**
Flukse monetare nga aktiviteti investues			
Arketime/(Pagesa) në Asete Fikse	7	59,008,360	(400,015,490)
Investime në tituj pronësie dhe pagesa për filjalet	6	19,219,196	(19,219,196)
Hua	6	(25,671,540)	-
Flukse monetare të përdorura në aktivitet investues		**52,556,016**	**(419,134,686)**
Flukse monetare nga aktiviteti financiar			
Hua të mara / (të paguara)	12	(119,837,267)	283,607,668
Dividend i Paguar	13	(54,300,000)	(170,305,000)
Flukse monetare neto nga aktiviteti financiar		**(174,137,267)**	**113,302,668**
Rritje/rënie në mjete monetare		**35,822,575**	**(2,523,326)**
Mjete monetare në fillim të vitit	1	36,567,719	3,268,470
Mjete monetare në fund të vitit	1	**745,144**	**745,144**

Pasqyra e Flukseve Monetar duhet lexuar e lidhur me Shënimet shpjeguese në faqet 8-22, pasi janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR VITIN QË MBYLLET MË 31 DHJETOR 2020

	Kapitali i regjistruar	Rezerva ligjore dhe statutore	Fitime te mbetura	Fitimi i periudhës	Total
Më 1 Janar 2019	232,100,000	32,276,769	58,845,336		323,222,105
Transferime në Kapital	(90,100,000)	-	-		(90,100,000)
Transferime në Rezervë Ligjore	-	(21,400,000)	-		(21,400,000)
Fitimi i shpërndarë	-	-	(58,805,000)		(58,805,000)
Fitimi i vitit 2019	-	-		54,276,989	54,276,989
Më 31 Dhjetor 2019	**142,000,000**	**10,876,769**	**40,336**	**54,276,989**	**207,194,094**
Më 1 Janar 2020	142,000,000	10,876,769	54,317,325		207,194,094
Transferime në Kapital	-	-	-		-
Transferime në Rezervë Ligjore	-	-	-		-
Fitimi i shpërndarë (Shënimi 13)	-	-	(54,300,000)		(54,300,000)
Fitimi i vitit 2020	-	-		78,378,411	78,378,411
Më 31 Dhjetor 2020	**142,000,000**	**10,876,769**	**17,325**	**78,378,411**	**231,272,505**

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital duhet lexuar e lidhur me shënimet shpjeguese në faqet 8-22,pasi janë pjesë përbërëse e këtyre Pasqyrave Financiare

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

I. Informacion i Përgjithshëm

"Ante-Group" shpk (ose Shoqëria) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më datë 06 Qershor 1996 dhe është regjistruar në Regjistrin Tregëtar të Shoqërive me NUIS J62904100D.

Shoqëria zotërohet nga Ortakët, Bardhjus Bushaj në mazhorancë 49% dhe katër ortakë të tjerë me përqindje të barabartë në pjesmarrje.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 142.000.000 Lekë.

Administratorë të Shoqërisë janë :

z. Bardhjus Bushaj - Administrator i Përgjithshëm

z. Gjysho Merko - Administrator i Përgjithshëm

znj. Elma Doci - Administratore teknike

Aktiviteti kryesor

Shoqëria kryen aktivitet në fushën e shërbimeve komunale dhe urbane (pastrim urban) si dhe ndërtime civile dhe rikonstruksione në ndërtim.

Adresa e selisë dhe vendi i biznesit

Adresa e selisë është : "Lagjia Barrikada, Rr. Antipatrea, Godina Nr. 3/105, Berat".

Në funksion të aktivitetit të saj dhe kërkesave ligjore, Shoqëria ka regjistruar edhe disa vende të tjera ku ushtron aktivitet.

Ambienti i biznesit dhe veprimtarisë

Shoqëria ka nënshkruar në Prill 2018, me Bashkinë Tiranë, "Kontratë sipërmarrje për shërbimin e pastrimit urban" të një zone të kryeqytetit për një afat 3-vjecar nga data e nënshkrimit. Kjo kontratë është në vazhdimësi pasi Shoqëria ka kryer këtë shërbim edhe gjatë viteve të mëparshëm. Shoqëria e ripërsëritur këtë Kontratë edhe në vazhdimësi, duke filluar nga viti 2021 deri në vitin 2024.

Shoqëria ka nënshkruar në Mars 2018, me Bashkinë Mat, "Kontratë sipërmarrje për shërbimin e pastrimit urban" të këtij qyteti për një afat më shumë se 3-vjecar nga data e nënshkrimit (e vlefshme deri më 31.12.2021). Kjo kontratë nënshkruhet për herë të parë me këtë Bashki.

Shoqëria ka nënshkruar në Prill 2019 me Bashkine Berat, "Kontratë sipërmarrje për shërbimin e pastrimit urban" të këtij qyteti për një afat 5-vjecar nga data e nënshkrimit. Kjo kontratë është në vazhdimësi pasi Shoqëria ka kryer këtë shërbim edhe gjatë viteve të mëparshëm, duke filluar nga viti 1996 e në vazhdimësi.

Gjatë vitit 2020 Shoqëria ka lidhur disa kontrata ndërtimi dhe rikonstruksioni duke u bërë pjesë e procesit të Rindërtimit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

II. Bazat e përgatitjes

II.1. Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat Financiare të "Ante Group"shpk, janë hartuar në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, vecanërisht SKK2, dhe ligjin nr.25/2018 datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare." Ato pasqyrojnë përditësimet që u janë bërë SKK-ve dhe kërkesave për zbatimin e tyre të nxjerra nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

II.2. Baza e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike dhe parimit të të drejtave të konstatuara.

II.3. Vijimësia

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vazhdimësisë, i cili parashikon se Shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë për një të ardhme të afërt duke qënë në gjendje të realizojë asetet dhe të shlyejë detyrimet në një proces normal aktiviteti.

Referohuni *Shënimit III.15.* për pasiguri në lidhje me ngjarjet dhe kushte që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në bazë të parimit të vijimësisë.

II.4. Periudha raportuese dhe krahësueshmëria

Periudha raportuese përfshin një periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon më 1 Janar 2020 dhe përfundon më 31 Dhjetor 2020. Pasqyrat Financiare janë përgatitur në bazë krahësuese. Nuk ka ndryshim të politikave kontabël, krahasuar me periudhën ushtrimore të kaluar.

II.5. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Llogaritë e përfshira në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë, janë vlerësuar duke përdorur monedhën primare të ekonomise vendase në të cilën Shoqëria operon (monedha funksionale). Pasqyrat Financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptare (LEKË) që është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

II.6. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në përvojën historike të aktivitetit dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë ngjarjet e pritshme të së ardhmes që besohet në mënyrë të arsyeshme se mund të ndodhin nga rrethanat.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

III. Përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabile

III.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë, rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Kursi i këmbimit në monedhën shqiptare në datën e raportimit të Pasqyrave Financiare, është si më poshtë:

	2020	2019
EUR/Lek	123,70	121,77
USD/Lek	100,84	108,64

III.2. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë pasqyruar me vlerën e drejtë. Ato përfshijnë gjendjen monetare në arkë dhe në bankë si dhe investime afatshkurtra me likujditet të lartë dhe afat maturimi më pak se tre muaj të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe mund të përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

III.3. Kërkesat për tu arkëtuar

Kërkesat për tu arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra apo afatgjata për tu arkëtuar, paraqiten në Pasqyrë me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për tu arkëtuar në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale, minus provizionet e krijuara nga rënia në vlerë, kështu që ato janë të paraqitura me vlerën neto të realizueshme.

Kërkesat për arkëtim, janë njohur kryesisht në bazë të një fature, kontrate apo dokumentave të tjerë kontabël.

III.4. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

III.4. Inventarët (vazhdim)

Në rastin e prodhimit, kostoja përfshin materialet e papërpunuara, punën e drejtpërdrejtë, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet e tjera të drejtpërdrejta (duke përfshirë shërbimet e jashtme dhe amortizimin) dhe shpenzimet direkte të prodhimit, por përjashton kostot administrative dhe financiare.

Kostoja e inventarëve përcaktohet me metodën e mesatares së ponderuar.

Inventari matet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është me çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë aktivitetit normal minus kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

III.5. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra përfaqësojnë shpenzimet e bëra gjatë vitit financiar por që u përkasin periudhave të ardhshme të njësisë ekonomike. Për to është ndjekur politika kontabël kosto minus zhvlerësimin nqs ka të tillë.

III.6. Aktivet Afatgjata Financiare (Tituj pronësie në njësitë brenda grupit)

Zotërimet e titujve të pronësisë në shoqëri të tjera, (duke përjashtuar Shoqëritë që zotërohen plotësisht ose në mënyrë maxhoritare dhe që ndryshe quhen filiale apo degë), paraqiten në këtë zë, me vlerën e investimit.

Konsiderohen filiale/degë të zotëruara, nqs shoqëria ka fuqi mbi filialin/degën, të tillë që ekzistojnë të drejta që i japin asaj mundësinë të ushtrojë kontroll efektiv mbi vendimarrjen e filialit/degës.

Në rast të zotërimit (kontrollit) të plotë ose maxhoritar, Shoqëria përgatit Pasqyra financiare të konsoliduara duke filluar nga data e fitimit të kontrollit. Nqs Shoqëria e humb kontrollin, pasqyrat financiare çkonsolidohen (për filialin/degën) duke nisur nga kjo datë.

Në rast se filiali/dega janë jo materiale, Shoqëria nuk i konsolidon në pasqyrat e veta financiare, por paraqet vetëm vlerën e investimit.

III.7. Aktivet Afatgjata Materiale

Njohja fillestare

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi (nëse ka).

Kostoja historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivit.

Kostoja përfshin koston e ndërtimit ose çmimin e blerjes, përfshirë detyrimet e importit dhe taksat e pakthyeshme si dhe kostot e lidhura në mënyre të drejtpërdrejtë me sjelljen e asetit në gjendje pune, duke kuptuar me këtë, kostot e instalimit, tarifat profesionale si për arkitektët apo inxhinierët, si dhe kostot e vlerësuara për cmontimin, rregullimin e vendit apo zhvendosjen e asetit.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

III. 7. Aktivet Afatgjata Materiale (vazhdim)

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të ndërtesave, makinerive, apo AAM-ve të tjera, është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës, në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të makinerive, pajisjeve apo AAM-ve të tjera, janë njohur në të ardhura ose shpenzime, në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha asetet materiale, është metoda mbi vlerën e mbetur. Toka dhe AAM në proçes, nuk amortizohen. Normat vjetore të amortizimit, për klasat kryesore të aseteve janë si më poshtë :

- Ndërtesa 5%
- Makineri dhe paisje 20%
- Mjete transporti 20%
- Paisje kompjuterike 25%
- Paisje zyre dhe mobilje 20%
- Të gjitha asetet e tjera materiale 20%

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre mbetur dhe merren parasysh ne nxjerrjen e rezultatit operativ te vitit.

Aktivet e marra me qira

Aktivet e marra me qira janë të klasifikuara si qira financiare kur termat e transferimit të risqeve dhe pronësisë kalojnë te qiramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera janë të klasifikuara si qera operative.
Asetet që janë rregjistruar si qera financiare regjistrohen si asete të Shoqërisë me vlerën e drejtë në datën e fillimit të qerasë, ose me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë nëse kjo e fundit është më e vogël.
Pagesat e qerasë regjistrohen sipas detajimit përkatës në shpenzimeve financiare dhe zvogëlim të detyrimit të qerasë.

III.8. Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë të marrë, neto nga kostot fillestare të drejtpërdrejta për lidhjen e kontratës. Pas njohjes fillestare, huatë që mbartin interes regjistrohen me kosto të amortizuar, me metodën e normes së interesit efektiv. Cdo diferencë midis shumave të marra (neto nga kostot fillesate të drejtpërdrejta) dhe vlerës së rimarrjes, njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes.

Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveçse kur Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së raportimit. Klasifikohen afatshkurtra edhe pjesa e huave dhe detyrimeve të qerasë financiare që do të paguhen brenda 12 muajve të ardhshëm, duke ndjekur politikën kontabël të kostos së amortizuar.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

III.9. Llogaritë e pagueshme

Të pagueshmet tregtare i referohen të pagueshmeve për shërbimet ose mallrat nga furnitorët gjatë aktiviteteve të rregullta tregtare. Ato klasifikohen si detyrime afatshkurtra nëse pagesa është brenda një viti ose më pak (ose brenda ciklit të rregullt të aktiviteteve operative nëse është më e gjatë); përndryshe, ato njihen si detyrime afatgjata.

Të pagueshmet tregtare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

III.10. Kapitali i Aksionerëve

Pjesët e zotëruara nga ortakët, janë klasifikuar në Kapitalin Regjistruar të Shoqërisë, pjesë kjo e Kapitaleve të Veta. Dividentët (fitimi i shpërndare) është njohur si zbritje nga Kapitalet e Veta në momentin që ato janë deklaruar.

Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë (kryesisht nga fitime të realizuara në periudhat e mëparshme ushtrimore), është paraqitur në momentin që ato janë deklaruar në QKB.

III.11. Tatimet aktuale dhe ato të shtyra

Tatimi mbi Fitimin

Shpenzimi për Tatimin mbi Fitimin (i treguar në Pasqyrën e Performancës Financiare) përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar lidhur me rezultatin e vitit ushtrimor. Tatimi i fitimit i pagueshëm për vitin aktual, llogaritet mbi fitimin e tatueshëm i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në Pasqyrën e Performancës Financiare, sepse korrektohet për shpenzime të panjohura apo të ardhura të patatueshme, këto sipas përcaktimit të legjislacionit fiskal.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020, është 15%, dhe nuk paraqet ndryshim nga periudha e mëparshme ushtrimore.

Detyrimi ose mbipagesa e Tatimit mbi Fitimin (e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar) lidhet me vlerën e mbetur të këtij detyrimi pasi nga detyrimi i llogaritur dhe i treguar në Pasqyrën e Performancës Financiare është zbritur tatim fitimi i paguar si paradhënie gjatë vitit 2020 shtuar me ndonje vlerë të mbetur si mbipagesë nga periudha e mëparshme ushtrimore nqs kjo vlerë nuk është rimbursuar.

Tatimet e shtyra llogariten duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen efektive në fund të periudhës raportuese, të cilat priten të aplikohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra njihen në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit ato të mund të përdoren.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

III.11. Tatimet aktuale dhe ato të shtyra (vazhdim)

TVSH

Të ardhurat, shpenzimet dhe asetet njihen me vlerën neto (që nuk e përfshin TVSH-në), përvecse në rastet

- kur ndodh blerje aseti, malli apo shërbimi për të cilën autoritetet tatimore nuk lejojnë kreditimin e TVSH-së. Në këtë rast TVSH-ja është pjesë e kostos së blerjes së asetit, mallit apo shërbimit.
- të kërkueshmet dhe të pagueshmet tregëtare, tregohen me TVSH të përfshirë
- në procesin e blerjes së materialeve dhe faturimit të shërbimeve, kontraktuar dhe realizuar në kuadër të procesit të Rindërtimit nga pasojat e tërmetit të 26 Nëntorit 2019.

III.12. Fondi i pensioneve (Sigurimet e detyrueshme Shoqërore), dhe pagesat për Sigurimet Shëndetsore

Shoqëria paguan kontributet për pensione si dhe kontribute për sigurim shëndetsor të punonjësve të saj, sic është parashikuar në legjislacionin kombëtar të punës. Kontributet e llogaritura njihen si shpenzime të vitit aktual dhe derdhen në llogari të organizmave kombëtare përgjegjës për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

Sipas Kodit të Punës, në kohën e daljes në pension, Shoqëria nuk është e detyruar të paguajë pensione për punonjësit. Pagesa e pensioneve dhe të tjera të mundshme, janë detyrim i Institutit Kombëtar të Sigurimeve Shoqërore.

III.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij.

Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

III.14. Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen në kontabilitet sipas parimit të të drejtave të konstatuara.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve ekonomike.

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njihen në pasqyrën e të ardhurave në përpjesëtim me volumin e shërbimit të kryer deri në datën e bilancit. Volumi i shërbimit vlerësohet duke iu referuar survejimeve të punës së kryer.

Shpenzimet njihen kur ato sigurohen prej të tretëve dhe mbi bazën e të drejtave të konstatuara, dmth në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

III.15. Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet kritike të kontabilitetit vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike të aktivitetit dhe faktorë të tjerë duke përfshirë ngjarjet e pritshme të së ardhmes që besohet në mënyrë të arsyeshme se mund të ndodhin nga rrethanat.

Drejtimi bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet faktike. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material, në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Vijimësia si pasojë e Covid-19

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi, situatë që vazhon të njihet si e tillë në Shqipëri dhe në mbarë botën. Proçesi masiv i vaksinimit dhe për rrjedhojë lehtësimi i masave kufizuese nga qeveritë, po nxit pritshmëritë se situata pandemike mund të jetë drejt mbarimit. E gjitha kjo po reflektohet në përgjigjen pozitive të tregjeve të aksioneve dhe të punës.

Sidoqoftë, në datën e paraqitjes së këtyre Pasqyrave Financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Shënime për informacionin financiar

1. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Banka		
Gjendje Banke, në monedhë vendase	36,497,316	613,350
Gjendje Banke, në monedhë të huaj	28,787	14,578
Arka		
Gjendje Arke	41,616	117,216
Totali	**36,567,719**	**745,144**

2. Llogari të Arkëtueshme Tregëtare

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Klientë për shitje dhe shërbime	358,429,323	121,364,073
Totali	**358,429,323**	**121,364,073**

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

3. Llogari të tjera të arkëtueshme

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Debitorë të tjerë	7,021	14,588,853
Tatim Fitimi i mbipaguar	-	-
TVSH për tu rregulluar	4,404,284	5,822,730
Parapagime	3,000,000	6,290,991
AAM për të shitur	20,260,206	44,494,792
Totali	**27,671,511**	**71,197,366**

4. Inventari

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Materiale ndihmëse	22,264,796	22,428,745
Totali	**22,264,796**	**22,428,745**

Vlerat e inventarit të paraqitur më sipër përputhet me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve të kryera në fund të vitit ushtrimor.

5. Shpenzime të periudhave të ardhshme

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime për realizim kontrate (rinovim kontenierë)	1,327,295	6,636,474
Shpenzime të faturuara për periudhat e ardhshme	11,319,583	23,256,923
Totali	**12,646,878**	**29,893,397**

Shpenzimet për "Rinovim konteniere", si detyrim kontraktual nga kontrata 3-vjecare për pastrimin e qytetit të Tiranës, (e lidhur më 27.04.2018), është trajtuar nga Shoqëria si shpenzim i parapaguar. Amortizimi i këtyre shpenzimeve përfshihet në rezultat me kuota fikse përgjatë periudhës që kontrata është në fuqi.

"Shpenzime të faturuara për periudhat e ardhshme", lidhet me punime të kryera dhe të faturuara nga të tretë, por që lidhen me të ardhura që do faturohen dhe arkëtohen në periudha të ardhshme ushtrimore.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

6. Tituj pronësie në njësitë brenda grupit dhe Hua

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Tituj pronësie në njësitë brenda grupit, Hua Filjaleve	-	19,219,196
Huadhënie	25,671,540	-
Totali	**25,671,540**	**19,219,196**

Shoqëria ka zotëruar 100% Shoqërinë "Lion Construction" shpk, dhe njëkohësisht e ka financuar për nevojat e saj. Aksionet e Shoqërisë "Lion Construction" shpk, janë shitur në masën 100% para datës së mbylljes së këtyre Pasqyrave Financiare. Huatë e dhëna gjatë vitit 2020, janë pasqyruar në zë më vete.

7. Aktivet Afatgjata Materiale

	Ndërtesa	Makineri e Pajisje	Pajisje zyre dhe informatike	Mjete transporti	Toka	Totali
A.A M. me vlere fillestare						
Gjendje 01.01.2020	140,074,970	14,397,479	9,458,593	152,715,358	3,500,000	320,146,400
Riklasifikim	-	-	-	-	-	-
Shtesa		1,386,522	1,068,742	3,966,374		6,421,638
Pakesime	(93,837,740)	-	-	(6,493,779)	(1,225,000)	101,556,519)
Gjendje 31.12.2020	**46,237,230**	**15,784,001**	**10,527,335**	**150,187,953**	**2,275,000**	**225,011,519**
Amortizimi						
Gjendje 01.01.2020	16,785,170	5,948,642	4,873,328	66,667,830	-	94,274,970
Riklasifikim	-	-	-	-	-	-
Shtesa	3,765,390	1,767,939	1,044,749	17,354,087	-	23,932,176
Pakesime	13,296,560	-	-	(5,696,184)	-	(18,992,744)
Gjendje 31.12.2020	**7,254,000**	**7,716,581**	**5,918,077**	**78,325,744**	-	**99,214,402**
Vlera neto 01.01.2020	123,289,800	8,448,837	4,585,265	86,047,528	3,500,000	225,871,430
Vlera neto 31.12.2020	**38,983,230**	**8,067,420**	**4,609,258**	**71,862,209**	**2,275,000**	**125,797,117**

Paraqitja e Aktiveve Afatgjata Materiale është e plotë, ato ekzistojnë dhe janë në pronësi të Shoqërise. Ato janë të ngarkuara me hipoteka dhe barra sigurie për shkak të kredive të marra nga Shoqëria.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

8. Hua Afatshkurtra

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Hua afatshkurtër dhe Leasing	185,884,634	171,177,761
Totali	**185,884,634**	**171,177,761**

Pasqyrohet detyrimi Leasing dhe pjesa e huasë afatgjatë për tu paguar gjatë 2020, sipas plan pagesës së miratuar.

9. Arkëtime në avancë për porosi

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Të ardhura të periudhave të ardhme	69,977,740	-
Totali	**69,977,740**	**-**

Paraqiten parapagimet e faturuara gjatë vitit 2020, për furnizime me mallra ose shërbime që do të realizohen gjatë vitit 2021. (referoju Shënimit 21, më poshtë).

10. Detyrime për Furnitorë

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Furnitorë për materiale dhe shërbime	349,078,033	183,145,134
Totali	**349,078,033**	**183,145,134**

Detyrimet lidhen me furnizime mallra dhe shërbime me pagesë të mëvonshme. Sipas verifikimeve që u kryen rezulton se shuma e paraqitur rakordon me inventarin kontabël më date 31.12.2020 dhe përfaqëson detyrime që Shoqëria nuk i ka shlyer deri në këtë datë.

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

11. Detyrime të tjera aktuale

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Detyrime për Sig.shoqërore dhe shëndetsore	2,815,911	2,190,443
Detyrime për TAP	581,796	546,126
Detyrime për TVSH	26,520,347	49,781
Detyrime për Tatimin mbi Fitimin	8,381,847	1,733,099
Detyrime per Tatimin ne Burim	63,885	57,317
	38,363,786	4,576,766
Paga për tu paguar	13,378,174	7,786,877
Dividentë për tu tërhequr	85,346,410	129,414,200
Totali	**137,088,370**	**141,777,843**

Shoqëria ka paguar deri në hartimin e këtij Raporti, detyrimet tatimore dhe pagat, të paraqitura më lart dhe që lidhen me muajin Dhjetor 2020.

12. Hua afatgjata

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kredi bankare hipotekore	10,462,166	131,494,336
Kredi bankare-Leasing	23,596,442	37,108,412
Totali	**34,058,608**	**168,602,748**

13. Kapitali i Aksionerëve

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kapitali i Nënshkruar	142,000,000	142,000,000
Rezerva Ligjore	1,810,000	1,810,000
Rezerva për investime	9,066,769	9,066,769
Fitime të pashpërndara	17,325	40,336
Rezultati i periudhës	78,378,411	54,276,989
Totali	**231,272,505**	**207,194,094**

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

"Ante Group" shpk, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të së drejtës shqiptare më datë 06 Qershor 1996.

Sipas Regjistrit Publik të Shoqërive Tregëtare, shoqëria ka regjistruar dhe ka paguar plotësisht kapitalin, në shumën 142,000,000 Lekë, i cili tashmë përbëhet nga 142,000 pjesë (1,000 Lekë për pjesë).

Më datë 29.07.2020, Asambleja e Përgjithshme ka aprovuar shpërndarjen e gjithë fitimit të realizuar gjatë vitit 2019 dhe ndonjë rezervë tjetër, për shumën totale 54,300,000 Lekë.

Në mënyrë analitike, numri i pjesëve dhe vlera e zotëruar nga seicili prej Ortakëve, paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020		31 Dhjetor 2019	
	Nr. i pjesëve	Ekuivalenti në Lekë	Nr. i pjesëve	Ekuivalenti në Lekë
Bardhjus Bushaj	69,580	69,580,000	69,580	69,580,000
Entela Merko	18,105	18,105,000	18,105	18,105,000
Gjysho Merko	18,105	18,105,000	18,105	18,105,000
Enka Merko	18,105	18,105,000	18,105	18,105,000
Kristian Merko	18,105	18,105,000	18,105	18,105,000
Totali	**142,000**	**142,000,000**	**142,000**	**142,000,000**

- Rezervat Ligjore dhe Statutore

Rezerva Ligjore është krijuar në masën 5% të fitimit pas tatimit, në përputhje me ligjin nr. 9901 datë 14 Prill 2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i cili parashikon gjithashtu që Rezerva Ligjore të krijohet deri në masën 10% të kapitalit. Gjatë vitit 2020, Rezerva Ligjore dhe ajo për Investime nuk kanë ndryshuar.

14. Të ardhurat

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Pastrime urbane dhe Punime ndërtimore	981,319,808	589,246,095
Shitje AAM	130,354,412	51,768,202
Puna e kryer dhe e kapitalizuar	-	-
Shitje të tjera	4,785,378	8,608,933
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	**1,116,459,598**	**649,623,231**
Të ardhura të tjera (financiare)	-	10,102,632
Totali	**1,116,459,598**	**659,725,863**

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

15. Shpenzimet materiale

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kostoja e materialeve të përdorura	275,051,420	210,633,039
Të tjera shpenzime	24,234,586	18,596,596
Totali	**299,286,006**	**229,229,635**

Llogaritja e kostos së plotë të materialeve të përdorura, është bërë duke marrë në kosideratë të gjitha shpenzimet e marrjes se tyre, të cilat përfshijnë të gjitha shpenzimet deri në magazinimin e tij.
"Të tjera shpenzime", përfaqëson koston e ndërtimit të njësive (apartamente, garazhe) lidhur me objektin "5 Maji' dhe që janë shitur gjatë periudhës ushtrimore.

16. Kostoja e punës

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Pagat	115,989,661	106,933,595
Kontributi për Sigurime Shoqërore	14,729,519	13,477,979
Kontributi për Sigurime Shëndetsore	2,010,516	1,850,726
Totali	**132,729,696**	**122,262,300**

Numri mesatar i të punësuarve në Shoqëri gjatë vitit 2020 ka qënë 246 të punësuar (2019: 226). Struktura e të punësuarve është : Administratë 20, Personel inxhiniero-teknik 18, fuqi punëtore 208.

17. Shpenzime amortizimi

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Ndërtesa	3,765,390	2,089,658
Makineri e Pajisje	1,767,939	1,726,784
Mjete transporti	17,354,098	21,116,107
Pajisje zyre dhe mobilje	686,984	831,357
Pajisje informatike	357,765	370,690
Totali	**23,932,176**	**26,134,596**

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

18. Shpenzimet operative

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Qera	6,439,122	5,929,394
Shp. Postare, telefoni dhe internet	1,503,662	1,276,584
Kuota e shp. të periudhave të ardhme	5,309,179	4,613,526
Taksa vendore dhe taksa të tjera	899,098	1,630,851
Shp. për energji elektrike dhe ujë	988,704	953,724
Shërbime bankare	761,127	781,524
Shp.administrative dhe kancelari	5,928,740	6,653,099
Mirëmbajtje dhe riparime	9,209,853	6,598,761
Shërbime nga të tretë	422,258,702	155,878,076
Vlera kontabël e AAM të shitura	82,563,775	21,766,187
Gjoba dhe penalitete	3,078,634	2,457,673
Publicitet dhe reklama	10,894,481	150,000
Shp. për studime dhe kërkim	2,806,400	826,173
Sigurim oferte, prone, etj	4,084,865	3,390,283
Shp. Pritje dhe përfaqësime	555,144	595,167
Transporte për blerje	2,882,868	-
Totali	**560,164,354**	**213,501,022**

19. Shpenzime financiare neto

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Interesa për kredi	(6,619,400)	(4,309,322)
Fitim/Humbje nga këmbime valutore	(974,782)	-
Totali	**(7,594,182)**	**(4,309,322)**

20. Shpenzimet e Tatimit mbi Fitimin

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Teprica e mbartur/(Detyrimi për t'u paguar)	(1,733,099)	(6,721,753)
Tatim Fitimi i paguar për llogari të vitit të kaluar	1,733,099	6,721,753
Tatim Fitimi i parapaguar gjatë vitit	5,992,926	9,278,900
Kompesime për detyrime të tjera tatimore	-	-
Shpenzimi për Tatim Fitimin	(14,374,773)	(11,011,999)
Tatim Fitimi i mbipaguar/(për t'u paguar)	**(8,381,847)**	**(1,733,099)**

(të gjitha shumat janë të shprehuara në Lekë, përvecse kur është shprehur ndryshe)

21. Rakordimi i shifrës së afarizmit

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Totali i të Ardhurave sipas FDP-ve të TVSH-së	1,186,437,338	649,888,874
Rregullime		
Plus të ardhura të faturuara në vitin paraardhës, të njohura në vitin aktual	-	-
Minus të ardhuara të faturuara në vitin aktual, që do njihen në vitin pasardhës	(69,977,740)	-
Të ardhura nga zbritje nga furnitorët apo grante	-	-
Të ardhura të tjera – amnisti fiskale	-	-
Të ardhura nga kursi i këmbimit valutor	-	9,836,989
Totali i të Ardhurave sipas FDP-së së Tatimit mbi Fitimin	**1,116,459,598**	**659,725,863**

22. Rezultati i periudhës

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitimi Bruto	92,753,184	64,288,988
Shpenzime të panjohura tatimore	3,078,634	2,457,673
Humbje të mbartura	-	-
Të ardhura të patatueshme	-	-
Fitimi tatimor	**95,831,818**	**66,746,661**
Shpenzimet e tatim fitimit	(14,374,773)	(10,011,999)
Fitimi neto i vitit financiar	**78,378,411**	**54,276,989**

V. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria mund të japë angazhime apo të përfshihet në pretendime apo veprime ligjore të ndryshme. Nuk raportohen të ketë përfshirje të tilla dhe gjithashtu drejtimi i Shoqërisë beson se edhe në të ardhmen e afërt nuk parashikohen ngjarje të tilla.

Shoqëria ka dhënë garanci dhe hipoteka për pasuri në pronësi të saj që lidhen me kredi të marra prej saj.

VI. Ngjarje pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.